

NERMIN BASHA

**EPIRI DHE BOTA ILIRE PRANË TIJ, NË VEPRËN E JUL
CEZARIT “MBI LUFTËN CIVILE”**
(vijon nga numri i kaluar)

Kreu 12 – Si shtiu në dorë Orikumin, pa asnjë vonesë, Cezari niset për Apoloni... Apolonianët dërgojnë përfaqësues te Cezari dhe e presin në portat e qytetit. Shembullin e tyre e ndjekin Bylinët, Amantinët, qytetet e tjera të afërta e gjithë Epiri dhe, si nisin përfaqësi te Cezari, e sigurojnë se do ta përkrahnin.¹

Kjo zonë, ku autori veç banorëve të Apolonisë, përmend edhe bylinët dhe amantinët, përfshirë “qytetet e tjera të afërta dhe gjithë Epirin” dërguan përfaqësi te Cezari për t’i treguar besnikëri dhe mbështetje, që do të thotë se gjithë kjo zonë i shprehu aleancë të vullnetshme, pa qenë nevoja për luftë e pushtim. Veç qyteteve Bylis dhe Amantia, si na thotë edhe autori i veprës, zona kishte edhe mjaft qytete të tjera, të afërvendosura me njera-tjetrën, ndoshta Meandria, Kestria etj., të cilët autori nuk i përmend, që janë zbuluar ose presin të zbulohen. Për Cezarin kjo zonë ishte shumë e rëndësishme dhe ai vetë na tregon se ishte furnizuar me grurë nga këto vende. Amantët, bylinët dhe gjithë banorët e tjerë të afërt të atyre zonave, duke qenë pro autoritetit të konsullit romak, jo vetëm nuk iu kundërvunë Cezarit, por shërbyen si një burim i mirë furnizimi në haje për ushtrinë e tij. Madje edhe më vonë, Cezari përdori rrugët e këtyre krahinave për të kaluar në Farsalë, ku zhvilloi betejën përfundimtare me Pompeun. Kushte klimatike të përshtatshme, pozicion gjeografik mjaft të mirë, kodra, fusha dhe lugina pranë lumenjsh me ujë të bollshëm, zona këto ku banonin fiset byline e amantine, që prodhonin

¹ *Recepto Caesar Orico nulla interposita mora Apollonian proficiscitur... Illi ad Caesarem legatos mittunt oppidoque recipiunt. Hos sequuntur Byllidenses, Amantini et reliquae finitimae civitates totaque Epirus et legatis ad Caesarem missis, quae imperaret, facturos pollicentur.* Cesare, *De bello civili*, liber tertius, Carlo Signorelli, Milano: 1938, f. 38.

drithëra buke në sasi të bollshme, gjë që dëshmohet nga farërat e gjetura, nga mokrat për bluarje, nga veglat bujqësore të punës; këta vendas zhvillonin blegtorinë, madje rritnin edhe bletë. Cezari është shumë i kursyer në emërtimin e vendeve, krahinave, qyteteve, popullsive etj., që takoi e që e ndihmuan, prandaj, përmendja e parthinëve, bylinëve, amantëve nga ana e tij, do të mendonim se është bërë jo vetëm për rëndësinë e madhe që patën këto popullsi për konsullin romak gjatë luftës me Pompeun, por edhe për përhapjen, zhvillimin, begatinë e këtyre trevave dhe bollëkun pranë këtyre popullsive, ku siguroi ndihmë e përkrahje. Edhe katër mbishkrimet e ndërtimit të gjetura në Bylisi dhe të datuara rreth viteve 549–550 të e.s.² tregojnë vazhdimësinë e jetës, begatinë dhe bukurinë e këtij qyteti të lashtë, siç e vërtetojnë edhe shprehje të përdorura në mbishkrime : *O i huaj, mos e shmang / vështrimin nga bukuria e / Bylisit, muret rrethuese të / të cilit, dikur të rrënuara, / i rëndërtoi Viktorini guximtar.*³ Këto mbishkrime, i përkasin periudhës së Justinianit, por tregojnë rëndësinë e dikurshme të Bylisit; vërtet tregojnë rëndësinë e ndërtesës ku qenë vendosur, dhe të mjeshtrit që i rindërtoi, por njëherazi flasin për qytetin me peshë të njëherë e një kohe, muret e të cilit, “*dikur të rrënuara*”, u restauruan ose u ndërtuan “*ex novo*”.

Pompeu, i ardhur para Cezarit në këto zona, nën pushtetin e romakëve prej disa dhjetra vjetësh, kishte rekrutuar ushtarë në Epir, mirëpo në një kapitull tjetër do të mësojmë se shumë nga këta kaluan, më pas, në anën e Cezarit. Qytete, si Apolonia, Orikumi, Bylisi e Amantia, pra, gjithë qytetet e korridorit bregdetar, madje edhe të tjera më në brendësi, nga prapatoka, ishin koloni në kohën e këtyre ngjarjeve. Natyrshëm lind pyetja : cili ishte raporti mes këtyre qyteteve me popullsitë vendase “barbarët amantë dhe bylinë”, që, më me shumicë ndodheshin në territoret përreth qyteteve? Si rezulton nga vetë zhvillimi i luftës, aleancës së një qyteti i bashkëngjitej, si një rrjedhojë natyrore, mundësia e shfrytëzimit në çdo kuptim e territorit që i përkiste atij.⁴ Edhe në Apoloni, Cezari qëndroi dy ditë, duke e përdorur mirë këtë kohë për domosdoshmëri masash ushtarake e duke rimarrë, më pas, marshimin nga

² Skënder Anamali, “Katër mbishkrime ndërtimi nga Bylisi”, *Monumentet*, 1, (33), Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë: 1987, f. 63.

³ Po aty.

⁴ Giorgio Veith, *La campagna di Durazzo tra Cesare e Pompeo*, Roma: 1942, f. 41.

dega jugore e rrugës Egnatia, drejt pikës së bigëzimit të saj. Gjatë marshimit, ai merr lajmin që Pompeu ia kishte dalë të futej mes tij dhe Dyrrahut, prandaj, duke kuptuar panevojshmërinë e vazhdimit të marshimit, Cezari qëndroi në pozicionin më të afërt, të përshtatshëm për mbrojtje të gjatë. Ai ndaloi pranë vendkalimit të Apsit, duke pasur pas krahëve, qytete të bashkuara me të dhe gjithë Epirin, e duke pritur pjesën e dytë vepruese të ushtrisë së tij. Bashkuar me të, Cezari do të kishte mundësi të ndërmerre sulmin.

Kreu 47 - Ata nuk kundërshtonin bollgurin, kur u jepej, as perimet, mirëpo parapëlqenin shumë mishin e bagëtisë, që sillej me shumicë nga Epiri.⁵

Detyra kryesore e një komandanti të përgjithshëm është sigurimi i hajes për ushtrinë, një detyrë jo e lehtë. Për më tepër, Cezari pati pak anije, me të cilat, me vështirësi mundi të transportonte një pjesë të ushtrisë, duke i mbetur në Itali pjesa tjetër. Komandantët e Pompeut, i bllokuan detin për të mos i lejuar as hedhjen e ushtarëve dhe as ushqime e materiale të nevojshme për luftën. Herëpashere gjatë rrëfimit, ndeshim e zbulojmë vështirësitë e Cezarit dhe të njerëzve të tij për të siguruar drithë dhe haje të domosdoshme për ushtrinë në trojet ilire. Vendet nën ndikimin dhe nën mbrojtjen e Cezarit, e ndihmojnë duke plotësuar nevojat e ushtrisë së tij. Ai duhej të merrte nga Epiri bagëti për të siguruar mish për ushtrinë, veçanërisht kur nuk kishte as sasinë e domosdoshme të grurit për bukë. Në Epir blegtoria kishte arritur një shkallë të mirë zhvillimi, për më tepër, mishi i bagëtisë epirote ishte shumë i shijshëm. Për kopetë e shumta e të mira të bagëtive na kanë lënë dëshmi edhe mjaft autorë të lashtësisë. Straboni përsërit Homerin : “Dymbëdhjetë kope në Epir, kaq shumë dhen kullosin”⁶; Hesiodi : “Është një fushë, Hellopia, shumë pjellore dhe me luadhe të mira / e pasur në dele dhe në qe këmbëharkuar; / këtu banojnë burra me shumë kope gjedhësh / dhe një sasi e panumërt fise mortarësh...⁷ Shkruan

⁵ *Non illis hordeum cum daretur, non legumina recusabant; pecus vero, cuius rei summa erat ex Epiro copia, magno in honore habebant. Cesare, De bello civili...*, f.83.

⁶ Strabonis, “Geographica”, në *Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë*, libri X, Tiranë: 1965, f. 164.

⁷ Hesiodi, “Carmina”, në: *Ilirët dhe Iliria ...*, fragmenti 134, Tiranë: 1965, f. 14.

Herodoti, i cili na tregon për kullotat e pasura të Apolonisë. Aristoteli në veprën e tij na jep këto të dhëna : “...Lopët e Epirit, të mëdhatë, japin nga një shtambë e gjysmë qumësht... Kafshët e mëdha kanë nevojë për shumë ushqim, por kjo krahinë ka shumë kullota të mira dhe vende të përshtatshme në çdo stinë. Qetë dhe delet më të mëdha janë ato që quhen pirrike, të cilat e kanë emrin nga mbreti Pirro...”.⁸ Varroni, që ka qenë një nga shkrimtarët më prodhimtarë të kohës antike dhe ka shkruar edhe një veper mbi ekonominë fshatare, në një nga përshkrimet e tij, na thotë : “Për blegtorinë do të flas shkurt dhe në mënyrë të përgjithshme, duke u mbështetur në bisedat që patëm me ata që kishin shumë bagëti në Epir...” ose “Në Epir thuajse të gjithë veprojnë në mënyrë që, për çdo njëqind dele, të kenë një bari dhe dy, po për kaq dhi”.⁹ Kopetë e Epirit i përmend edhe Plini : “Në hemisferën tonë, gjedhët epirotë lëvdohen së tepërmi. Kjo racë, sikurse thonë, i detyrohet kujdesit të Pirros...”¹⁰ Simbolet që janë përdorur në monedhat e qyteteve, si lopa me viçin, koka e dhisë etj., që i gjejmë në monedhat e qyteteve në jug, tregojnë për rëndësinë e gjedhëve në ekonominë e fiseve epirote. Kjo shprehje “*që sillej me shumicë nga Epiri*” tregon se, “në kohën e Cezarit, jeta ekonomike e Shqipërisë dhe, veçanërisht, e Epirit kufitar, bazohej kryesisht, në blegtori : industri natyrore në një vend, ku, për arsye topografike, jeta ekonomike kufizohej, thuajse tërësisht, në zonën e kodrave dhe të maleve”.¹¹ Madje sipas Cekës, cilësitë e larta të gjedhëve të tyre i çmonin edhe vetë epirotët, gjë për të cilën flet qartë një monedhë argjendi, prerë në Epir, e cila, si stemë shpine, paraqet një dem të racës kur po përgatitet të masë forcat e veta me kundërshtarin. Për më tepër, për vlerësimin që i bëhej gjedhëve të Epirit në botën antike, flet edhe fakti që, si simbol shpine mbi një monedhë argjendi të qytetit të Italisë Jugore, figuron pikërisht një dem i racës molose, i dalluar si i tillë me një mbishkrim të posaçëm.¹²

⁸ Aristoteli, “De animalium historia”, në: *Ilirët dhe Iliria ...*, libri III, 20, 522 b, Tiranë: 1965, f. 40.

⁹ M. Terentii Varronis, “De re rustica -Mbi ekonominë fshatare”, në: *Ilirët dhe Iliria ...*, libri II - hyrje dhe kreu 5, f. 79.

¹⁰ C. Plini Secundi, “Naturalis Historiae”, në: *Ilirët dhe Iliria ...*, libri VIII, kreu 45(70), Tiranë: 1965, f. 196.

¹¹ G. Veith, *La campagna ...*, f. 61.

¹² Hasan Ceka, *Në kërkim të historisë ilire*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë: 1998, f. 275.

Në kohë shumë më të vonshme, edhe Pukëvili na njofton për pasurinë e këtyre zonave me kope të gjësë së gjallë : “S’kaloi shumë kohë dhe ne mësuam se në Sazan s’ishim të vetëm. Brenda një kohe të shkurtër u shfaqën një sërë shqiptarësh të armatosur. Ata ishin kryesisht çobanë të bregut përballë, që transportonin dimrit vazhdimisht për në ishull kope të mëdha me dele e dhi ...”.¹³

Fjalja e Cezarit në këtë kaptinë të veprës së tij është një tjetër dëshmi që vjen nga lashtësia për zhvillimin e blegtorisë dhe pasurinë e trevave të Epirit në bagëti e në gjënë e gjallë, që ishte në gjendje të plotësonte nevojat për një ushtri, e cila numëronte mijëra trupa; madje jo vetëm kaq, ai na zbulon edhe shijen shumë të mirë të mishit të kësaj bagëtie. Duke pasur krahina me karakter kryesisht malor, kushte të përshtatshme klimaterike dhe kullota të shumta e të mira, popullsia i kishte kushtuar më tepër kujdes blegtorisë dhe prodhimeve të saj.

Kreu 61- ... Para këtij çasti, askush, qoftë këmbësor, qoftë kalorës, nuk kishte kaluar nga Cezari tek Pompeu, kurse, thujse përditë, linin Pompeun për të kaluar te Cezari, madje kishte deri dezertime në masë të ushtarëve të rekrutuar në Epir, në Etoli dhe në të gjitha ato zona, që ishin nën ndikimin e Cezarit.¹⁴

Cezari bën fjalë këtu për ushtarë të rekrutuar nga ana e Pompeut në Epir, Etoli e zona të tjera që atë kohë ishin nën ndikimin e Cezarit. Në kohëra më të hershme, Epiri kishte marrë qëndrim të hapur kundër Romës, pikërisht kur “Pirroja, mbreti i epirotëve, erdhi në Itali që t’u jepte ndihmë tarentinëve” (*PyrrhusEpirotarum rex, ut auxilium ferret Tarentinis, in Italiam venit*), njoftim që e gjejmë edhe te vepra e Tit Livit, dhe që duhet të ketë qenë kontakti i parë i romakëve me fiset ilire të Epirit, në kuptimin që e gjejmë të shprehur bukur te Teodor Mommsen, i cili thotë se Pirroja “qe i pari që u mat me romakët në fushë të betejës”, vëllimi I, libri 2, kreu 7, f. 360. Për më tepër, po sipas Mommsen-it : “Nga Pirroja fillojnë ato lidhje mes Romës dhe Eladës, të cilave u detyrohet gjithë drejtimi i mëpastajmë i qytetërimit antik dhe që,

¹³ Pukëvil, *Në oborrin e Vezirit të Janinës*, Shënime udhëtimi, shkruar 200 vjet më parë, Tiranë: “Horizont”, 1999, f. 62.

¹⁴ ...*Nam ante id tempus nemo aut miles aut eques a Caesare ad Pompeium transierat, cum paene cotidie (nonnulli) a Pompeio ad Caesarem perfugerent, vulgo vero universi in Epiro atque Aetolia conscripti milites earumque regionum omnium, quae a Caesare tenebantur. Cesare, De bello civili ...*, f.100.

për këtë arsye, janë (këto lidhje) një nga faktorët kryesorë të qytetërimit modern”. Jo pak dëme e humbje i kishte sjellë Pirroja romakëve dikur, prandaj, në çastin e përshtatshëm për ta dhe me gjetjen e një shkaku, romakët sulmuan vendin e tij dhe fillimisht, Anici, e më pas, Paul Emili, në vitin 168 para e.s., kishin rrënuar e bërë rrafsh me tokën mbi 70 qytete që i përkisnin, në pjesën më të madhe, molosëve, njoftim ky që na vjen nga Straboni, nga Tit Livi dhe autorë të tjerë të lashtësisë. Për këtë çast, te Pauly Wissowa në *Real Encyclopädie der Classischen Altertumswissenschaft*, Stuttgart 1905, f.2731, shkruhet se “një ndëshkim i tmerrshëm, që Niebuhr me të drejtë e quan hakmarrje të romakëve për ekspeditën e Pirros në Itali, ra mbi epirotët e sidomos mbi molosët, kur romakët e Paul Emilit shkatërruan 70 qytete dhe skllavëruan 150 mijë burra”. Këta 150 mijë banorë, mes të cilëve drejtues të vendit e kryetarë familjesh, ishin shpërngulur prej tyre me forcë në Itali; një pjesë e tyre u kthyen në skllavër, një pjesë u torturuan e vdiqën, kurse mjaft të tjerë u riatdhesuan me kërkesën e qyteteve, sipas njoftimit të Justinut. Nëse vendi nuk do të ishte ripopulluar nga të rikthyerit e, ndoshta, edhe me kolonë, Pompeu nuk kishte ku dhe si të rekrutonte ushtarë po nga këto vise, kur dimë mirë se, në atë kohë, Roma rekrutonte ushtarë vetëm mes kolonëve dhe qytetarëve. Romakët nuk pranonin që skllavërit të bëheshin pjesë e ushtrisë romake. Edhe Katilina që bëri grushtin e parë të shtetit në Romë, në të gjitha përmasat klasike të një përbetimi, dhe kishte nevojë për sa më shumë forca, megjithëse skllavërit vrapuan nga çdo anë e Italisë në kërkim të lirisë dhe do të përbënin një kontigjent shumë të madh dhe të rëndësishëm si për nga numri, edhe për nga fuqia, Katilina nuk i pranoi mes forcave të veta.

Cezari na njofton përmes këtij kapitulli se as ushtarët dhe as kalorësit e tij nuk kishin braktisur Cezarin për të kaluar te Pompeu, ndërkohë që çdo ditë vinin ushtarë nga kampi i Pompeut drejt kampit të Cezarit dhe këta ishin kryesisht rekrutë, pra, kolonë e qytetarë nga Epiri e zona të tjera të afërta që e kishin siguruar Cezarin, me anë të përfaqësive të tyre, për mbështetje e përkrahje. Dhe “epirotët e kanë për gjë të madhe jo vetëm të luftojnë për atdheun e tyre, por edhe të japin jetën për të mbrojtur miqtë e tyre dhe farefisin”.¹⁵ Një përshkrim mjaft të bukur e domethënës na ka paraqitur shumë kohë pas ngjarjeve tona dhe më se 200 vjet më parë, lidhur me karakterin e shqiptarëve epirotas, Pukëvili,

¹⁵ Diodori, *Bibliotheca Historica*, Excerpt. Hoeschel, Tiranë: 1965, f. 145.

konsulli francez pranë Ali Pashë Tepelenës, veçori e karakteristika të trashëguara nga brezi në brez, që duhet t'i kenë njohur mirë edhe kryegjeneralët romakë. Pukëvili ka lënë këto dëshmi : “Ushtria e Ali Pashës, e përbërë nga shqiptarë të ambientuar me temperaturën e ftohtë të maleve dhe të veshur me guna të trasha, as që e ndjenin të ftohtit e stinës... Flinin me rroba të trasha, pa e hequr armën nga qafa, ishin të kënaqur për fatin që kishin dhe në gjithë këtë ushtri që numëronte mbi gjashhtë mijë vetë, s'kishte më shumë se njëzet të sëmurë. Siç dihej, shqiptarët s'ankoheshin kurrë pa shkak, sikurse duhet theksuar se asnjë ushtar nuk detyrohej të qëndronte nën armë me forcë. Përkundrazi, kur ndonjëri s'e ndjente veten mirë nga ana shëndetësore, lejohej të shkonte në shtëpi, por, duke menduar gjithmonë që, sapo të përmirësohej, të kthehej në radhët e ushtrisë sa më shpejt që të ishte e mundur. Krenar për profesionin e tij, ushtari shqiptar ndjehej i nderuar për plagët që merrte, të cilat i tregonte me krenari. Për të mos u zgjatur, me njerëz të tillë, po të kishin disiplinën e duhur, një gjeneral mund të bënte çudira dhe, ndoshta, të ndryshonte të gjithë faqen e lindjes...¹⁶ Shqiptarët mund të quhen skithët e perandorisë lindore. Ata s'kanë shumë pretendime ... s'duan t'ia dinë ndryshimeve të motit dhe gjithë jetën punojnë pa pushim. Ushqimi i tyre përbëhet nga qumështi, djathi, ulliri, perimet, peshku, vezët dhe, sipas rastit, mish në sasi të pakët. Përdorin pije të ndryshme, por më e përdorura është vera. Vera dhe vaji janë të shkëlqyera...¹⁷ Përveç trimërisë, që është e natyrshme te shqiptarët, ata janë krejt të çiltër, ... shprehin pa ndrojtje të mirën dhe të keqen...¹⁸ Do ta përfundoj përshtypjen time për shqiptarët, me vërejtjen se sa herë ata janë të bashkuar dhe formojnë një trup të vetëm, emri i tyre ngjall tmerr”.¹⁹

Kreu 78 - ...Prandaj, fillimisht dërgoi lajmëtarë te Domici me një letër ku i shpjegonte planet e veta, pastaj, si la në Apoloni katër kohorta për mbrojtje, një tjetër në Lis, tri në Orikum, si edhe ushtarët e plagosur, u nis vetë përmes Epirit dhe Atamanisë.....²⁰

¹⁶ Pukëvil, *Në oborrin e Vezirit ...*, f. 15.

¹⁷ *Po aty*, f. 39.

¹⁸ *Po aty*, f. 41.

¹⁹ *Po aty*, f. 42.

²⁰ ... *Itaque praemissis nuntiis ad Cn. Domitium Caesar scripsit et, quid fieri vellet ostendit praesidioque Apolloniae cohortibus IV, Lissi una, III Orici relictis,*

Meqë Cezari i shpëtoi nga duart për pakujdesinë e vet, Pompeu iu drejtua brendësisë së vendit, duke shpresuar të zinte në befasi Domicin, përfaqësuesin e Cezarit, i cili ishte dërguar në Maqedoni (kreu 36) për t'i bërë ballë Skipionit. Pompeu, duke qëndruar më në veri, mund të hidhej në rrugën Egnatia dhe ta zinte në befasi. Prandaj, Cezari, si kreu me shumë ngut detyrat e përmendura në këtë kaptinë, nisi marshimin tjetër, Apoloni –Tesali, duke ndjekur rrugën që nga Apolonia të çonte në Tesali, nëpër luginën e lumit Aos (Vjosa)²¹, dikur Aias²², deri në vargmalet e Pindit, pastaj nëpër luginën e lumit Peneu, që sipas studiuesve të Cezarit, rezulton të jetë rreth 350 km.. Edhe Hëze e komenton këtë çast të marshimit cezarian. Sipas tij, rruga nga duhej të kalonte ushtria cezariane përshkohej nga rrjedha të mëdha uji që derdheshin në det, në jug të qytetit të Apolonisë. Cezari duhej të ngjitej, në drejtimin juglindje, nëpër shtratin e ngushtuar të lumit Aos, pas të cilit ai mund të maskonte marshimin e tij; pasi kishte kaptuar pa pengesë të famshmet Gryka të Antigonesë, që dikur kishin ndaluar ushtritë romake, futet në luginën e lartë dhe deri në burimet e vetë lumit : jo larg prej këtej, zinxhiri i maleve të Pindit formon, duke u ulur, një qafë mali dhe ujërat e lumit fillonin të zbrisnin në një lumë tjetër, Peneu, rrjedha e lartë e të cilit e drejtoi Cezarin deri në hyrje të ultësirës tesaliane.²³ Për më tepër, dokumentet

quique erant ex vulneribus aegri depositis, per Epirum atque Athamaniam iter facere coepit. Cesare, De bello civili..., f.121.

²¹ G. Veith, *La campagna di Durazzo ...*, f. 25, shkruan kështu për rrjedhën e lumit Vjosa: “Me shkallë të lartë sigurie mund të saktësohen kushtet antike për Vjosën, Auos /Aias, Anas i shkrimtarëve të lashtë. Vetëm për këtë lumë është treguar zhvendosja e rrjedhës së tij në epokën historike. Dimë me siguri absolute që në antikitet lumi rridhte pranë qytetit të Apolonisë, duke formuar portin, i vendosur vetëm 10 stade (1,75 km.) nga qyteti, për t’u derdhur pastaj, pas 6-10 km., në det. Gryka e lumit është e zgjeruar në formën e një grykaje, dhe nuk gabohet, nëse pranohet se kështu duhet të ketë qenë edhe në lashtësi, sepse, vetëm kështu, ishte e mundur të ngjiteshe me anije të vogla deri në Apoloni në të gjitha stinët; ndërsa nuk mund të bëhej kjo gjë me Apsin, siç nuk bëhet dot as në ditët tona, megjithëse ai ka ujëra më të bollshme”.

²² Nicholas G.L. Hammond në veprën *Epiri, Qendra e Studimeve Ndërshqiptare*, Tiranë: 2004, f. 66, shkruan se emri i hershëm i lumit ishte dikur Aias, ndërsa tek *Iliada*, Ajaksi i pamposhtur mbante emrin e këtij lumi. Më pas, në kohët klasike u quajt Aaos, ndërsa tani quhet Aaos nga grekët, Vjosë nga shqiptarët dhe Bayasa nga vllahët.

²³ Léon Heuzey, *Les opérations militaires de Jules César*, Paris: 1886, f. 97.

historike tregojnë se po nga kjo rrugë, në vitin 198 para e.s. konsull Kuint Flamini, nisur po nga Apolonia, ashtu si Cezari rreth 150 vjet më pas, në vitin 48 para e.s., pasi kishte kapërcyer me pahir grykat e lumit Aos, kishte udhëhequr për herë të parë një ushtri romake në Tesali. Kryerja e këtij marshimi duhet të ketë zgjatur rreth 17-18 ditë, me një ecje jo më shumë se 20 km. në zona të vështira dhe deri 27 km. në ditë në zonë fushore. Atamania, nga duhej të kalonte Cezari, ishte krahinë e Epirit Jugor, kufi me Tesalinë. Banorët e saj ishin atamanët, që konsideroheshin barbarë nga grekët.²⁴ Cezari e përmend qytetin e tyre vetëm një herë. Në librin 23 të veprës së tij e përmend Polibi : “Senati nuk dinte nga t’ia niste për të zgjidhur të gjitha çështjet e veçanta që i paraqiteshin. Kishte përfaqësues të Tesalisë, në përgjithësi, dhe të çdo qyteti të saj, në veçanti; kishte nga Perrebia, Atamania, Epiri dhe Iliria”.²⁵ E përmend Tit Livi shumë herë në veprën e tij : “Gjatë rrugës mori me ngulm kështjellën e quajtur Feca, që gjendet midis Gomfit dhe grykave të ngushta, që ndajnë Tesalinë nga Atamania”;²⁶ ose më poshtë : “Kur Aminandrit të mërguar në Etoli, përmes letrave të njerëzve të vet, që i tregonin për gjendjen e Atamanisë, i lindi shpresa për të rishtënë në dorë mbretërinë, dërgoi njerëz të besuar pranë krerëve në Argitë, (që ishte kryeqyteti i Atamanisë), për t’i njoftuar se posa të merrte vesh që bashkëkombasit e tij do ta prisnin mirë, ai do të kthehej në Atamani, me ndihmën që do t’i jepnin etolët...”²⁷ ose “Filipi, si dëgjoji për kryengritjen e Atamanisë, i

²⁴ Pauly Wissova, *Real Encyclopädie der Classischen Altertumswissenschaft*, Fünfter Band, Stuttgart: “Popullsia”, 1905, f. 2718, duke u mbështetur në veprën e Strabonit, shkruan se “Teopompi sinjalizon jo më pak se 14 fise epirote”, mes të cilëve përmenden edhe atamanët. “Ata ishin të farës ilire”.

²⁵ Polibi, “Historitë” në: *Ilirët dhe Iliria...*, libri XXIII, kreu I, Tiranë: 1965, f. 65.

²⁶ Tit Livi, “Ab Urbe condita”, në: *Ilirët dhe Iliria ...*, libri XXIII, kreu 14, Tiranë: 1965, f. 111.

²⁷ T. Livii, *Ab Urbe condita*, tomus quartus, libri XXXVIII, kreu 1, Bassani 1778, f. 117. (*Exulanti tum Aminandro in Aetolia, litteris suorum, indicantium statum Athamaniae, spes recuperandi regni facta est, remissique nuntii ab eo principes Argitheam (id enim caput Athamaniae erat) si popularium animos satis perspectos haberet, impetrato ab Aetolis auxilio, in Athamaniam se venturum....*).

nisur me gjashtë mijë njerëz të armatosur, arriti në Gomfi me nxitim të madh”.²⁸

Si kuptohet edhe nga ky pasazh, Cezari dhe trupat e tij, nuk shkelën trojet tona vetëm përgjatë bregdetit, por edhe në prapatokë. Marshimet e shpejta, si tregohet në këtë kaptinë, por jo vetëm, nëpër luginën e Vjosës, nga Apolonia deri në Farsalë, në Tesali, për qëllime luftarake, flasin për një rrjet rrugor të zhvilluar. Shpejtësia e lëvizjes së trupave, të lë të kuptosh se ato duhet të kenë qenë të mira, sipas konceptit të kohës.

Gjithashtu, si është shprehur edhe gjuhëtari Mancaku, “Në dritën e të dhënave të toponimisë së lashtë”, Studime filologjike, 3-4, Tiranë 1982, f. 106, është me rëndësi edhe fakti që, një pjesë e mirë e këtyre emrave që “ruajnë dëshmi të pranisë së popullsisë shqipfolëse, janë emra qytetesh. Kjo tregon se popullsia që banonte aty e që u dha formën gjuhësore shqipe emrave të këtyre qyteteve, ... përbëhej nga popullsi që njihte mirë një jetesë të përparuar qytetare”.

Këta emra të përdorur nga Cezari, të krahasuar me trajtat e sotme, janë një dëshmi më tepër se elementi shqiptar banon në këto troje pa prerë, të paktën që nga koha romake, madje ai nuk ka munguar as në zonat bregdetare.

Nga të dhëna të tërthorta në veprën e Cezarit, mësojmë për prodhimin bujqësor e blegtoral dhe gjendjen ekonomike të popullsisë vendase, e cila, u detyrua të plotësojë nevojat e dy ushtrive më të mëdha të kohës, gjithsej, rreth 80 mijë trupave.

Duke përdorur “*terra germiniorum*” Cezari ka bërë të rritet numri i fiseve të njohura ilire. Ai na ka njohur me një fis të lashtë ilir në gjirin e fisit të madh të kaonëve, brenda territorit të të cilit ndodhej Paleste, Palasa e sotme. Me “terminët” e Cezarit, historia e fiseve epirote ilire plotësohet më mirë e më shumë duke na vërtetuar njëkohësisht vazhdimësinë e emrave ilirë në gojën e pasardhësve të tyre, të shqiptarëve. Palasa, vend me shkëmbinj të rrezikshëm, zbarkimi në të cilën përbën fillesën e fitores së konsullit romak, është bërë e njohur dhe na trashëgohet vetëm nga Cezari.

Sa u shkrua, është një pjesë e vogël e lëndës që mund të nxirret për historinë e lashtë të trojeve tona. Pavarësisht se Jul Cezari është mjaft i

²⁸ *Po aty*, tomus quartus, libri XXXVIII, caput 1, f. 118. (*Philippus, audita defectione Athamaniae, cum six millibus armatorum profectus, ingenti celeritate Gomphos pervenit*).

kursyer në përmendjen e emrave të vendeve, të qyteteve etj., edhe mjaft material tjetër mund të sigurohet nga vepra e tij; në kuadrin e shkencës së ilirologjisë, vepra e tij, në përgjithësi, shërben për të pasuruar e plotësuar dokumentacionin e historisë antike të vendit tonë ose ndihmon për të përforcuar një ose disa nga çështjet e kumtuara në burimet e shkruara. Duke përmendur emra territoresh, lumenjsh, qytetesh e më tepër, vepra e Cezarit u shtohet atyre studimeve të toponomastikës historike shqiptare, që kanë vënë në dukje se “mjaft nga emrat kryesorë të një treve të Ilirisë antike jugore, që shkon nga afërsitë e Raguzës, nga Ohri dhe arrin deri në Adriatik e Jon, përfshirë Vlorën e Çamërinë, ruajnë format karakteristike të evolucionit fonetik të gjuhës shqipe, që është një nga provat më bindëse dhe më të forta, e cila dëshmon se këto toponime kanë kaluar pa ndërprerë në gojën e së njëjtës popullsi, që nga koha e vonë e lashtësisë deri në Mesjetë”.

S u m m a r y

“EPIRUS AND THE ILLYRIAN WORLD IN THE WORK OF JULIUS CESAR, “ON THE CIVIL WAR”

Caesar continued his march towards Apollonia and after taking the city without any resistance because of the sympathy its citizens showed for him, he headed for Dyrrachium which had been his primary objective. On his long march he made several maneuvers for military purposes and to secure the needs of his army. He crossed through places, took under his protection the natives and made agreements with them, such as is the case of Amantines and Bulines and the whole of Epirot cities surrounding them. Considering Caesar's style of writing we believe that he mentions some of the Illyrian tribes and cities because they have had a particular importance for him and his army.

Apart from this, he introduces to us in a separate chapter the plant –*chara*– thought to be a plant today known as *ekelkaze*, which was used to prepare bread when grain was lacking. In addition Caesar also mentions the use of the tasty Epirot meat which the soldiers liked so much, giving an implicit overview of the livestock abundance which was grazed throughout the Epirot mountains and hills. The many frequent marches of Caesar and his army in the coastal area, but also in the interior of the country, near Berat, Elbasan and Tirana and later in the valley of Vjosa from Apollonia to Farsale, and Thessaly where he conducted

his victorious battle, testify for a developed network of roads. The regions where the Caesar's army passed through cover a large geographical area and the majority of the place names he mentions are city names, which means that the population living there was urban and had given to these names an Albanian form.